




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

12-06-2024

Ndësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
25	47	821	1



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Per:	Glauk Konjufca, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës Burim Dinarama, ud. i Drejtorit të Përgjithshëm AAC
Kopje elektronike:	Hykmete Bajrami, Kryetare e KMFP Armend Muja, Kryetar i KBPT
Nga:	Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës
SUBJEKTI:	Raporti i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2023.

Nr. Zyrës:	Ext:	Data: 12.06.2024
------------	------	------------------

Data	Zyra e Pranimi	Komentet/Veprimet	Inicialet	Afati
		Bashkangjitur mund të gjeni Raportin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin 2023. Sipas nenit 23, pika 5 të Ligjit nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, brenda 30 ditësh nga dita e pranimi të raportit final të auditimit, çdo institucion i audituar është i obliguar ta dorëzoj një Plan Veprimi ku përcakton se si do t'i adresoj rekomandimet e dhëna në raport.		

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

CAA

Nr. i prot. 2024/ZDP/182
Br. prot./Prot. Nr.
Faqe: 17 Kopje: _____ Datë: 12/06/2024
Stranica/Pages Kopija/Copy Datum/Date

Hyrës/ulazno/in ☒
Dakës/izlazno/out ☐
Brendshëm/intermo/internal ☐ Prishtinë/Prština/Pristina



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
12-06-2024			
PRAHODAR DOKUMENTI:			
UHPRIJMIJEN DOKUMENTI:			
RECEIVED SUBMITTED:			
Klasia Org.	Shif. klasif.	Nr. Prot.	Nr. i faqeve
Org. Jedin.	Klasif. Kod	Br. Prot.	Br. Stranica
Org. Unit	Class. Code	Prot. No.	No. Pages
05	47	824	1



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Za:	Glauk Konjufca, Predsednik Skupštine Republike Kosovo Burim Dinarama, Vršilac dužnosti Generalnog direktora ACV
Elektronski primerak:	Hykmete Bajrami, Predsednik KNJF Armend Muja, Predsednik KBRT
Od:	Vlora Spanca, Generalna Revizorka Republike Kosovo
PREDMET:	Izveštaj o reviziji godišnjih finansijskih izveštaja Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva 2023 godinu.

Br. Kancelarije: No. de bureau:	Ext: Poste:	Datum: 12.06.2024
------------------------------------	----------------	-------------------

Datum	Prijemna kancelarija	Komentari/Radnje	Inicijali	Rok
		U prilogu možete pronaći Izveštaj revizije za godišnje finansijske izveštaje Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva za 2023 godinu. Prema članu 23, stav 5 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnom Kancelariju Revizije, svaka revidirana institucija je obavezna da u roku od 30 od dana prijema završnog izveštaja podnese Akcioni Plan u kojem se određuje kako će adresirati preporuke koje su date u izveštaju.		



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL TË KOSOVËS PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1. Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AAC), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të AAC kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbytjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, e cila është paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjes dhe rekomandimit. Kjo gjetje dhe rekomandim ka për qëllim të bëjë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me një (1) rekomandim të përsëritur nga viti paraprak. Ne do ta përcjellim (shqyrtojmë) këtë rekomandim gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera neto e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 8,765€, pasurive jokatitale është 16,930€, si dhe vlera e stoqeve 3,499€.

Çështja B1 - Mos regjistrimi i pasurive jo kapitale në sistemin e-pasuria

Gjetja Neni 6.3 i rregullores MF nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, specifikon se Pasuria Kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jokatitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Pasuria jo kapitale (nën 1,000€) nuk ishte regjistruar në sistemin e-pasuria, përkundër kësaj AAC ka një regjistër të brendshëm në Excel nga i cili bënë shpalosjen e këtyre informatave në Pasqyrat Financiare.

Kjo ka ndodhur për shkak të angazhimit jo të mjaftueshëm të zyrtarëve përgjegjës për regjistrimin e pasurive në sistem.

Ndikimi Mos regjistrimi i pasurive në sistemin e-pasuria ndikon në mos përmbushjen e kërkesave ligjore për menaxhim të pasurisë. Po ashtu, regjistrimi i pasurive jo kapitale në Excel ku ekziston mundësia e ndryshimeve në çdo kohë pa lënë ndonjë gjurmë, rritë rrezikun që informatat e shpalosura në PFV mund të jenë të pasakta dhe jo të plota.

Rekomandimi B1 Drejtori i përgjithshëm duhet të sigurojë, që zyrtarët përgjegjës të bëjnë regjistrimin e pasurive jo kapitale në sistemin e-pasuria.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	922,281	810,061	739,945	750,068	876,303
Grante Qeveritare - Buxheti	922,281	804,133	739,945	750,068	876,303
Donacionet e jashtme	0	5,928	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 112,220€. Kjo ulje është rezultat i Vendimit të Qeverisë, nr. 69/2023 datë 27.12.2023.

Në vitin 2023 AAC ka shpenzuar rreth 91% të buxhetit përfundimtar ose 739,945€, me një rritje prej 7% krahasuar me vitin 2022. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	922,281	810,061	739,945	750,068	876,303
Pagat dhe mëditjet	768,543	650,395	650,395	693,109	768,117
Mallrat dhe shërbimet	150,000	155,928	88,958	56,377	106,378
Komunalitë	3,738	3,738	591	582	1,808

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 118,148€, si rezultat i vendimit të Qeverisë 69/2023 datë 27.12.2023. Këto mjete janë tërhequr si kursime buxhetore. Buxheti final ishte realizuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 5,928€. Buxheti final ishte realizuar rreth 57%, kjo vlerë e ultë e shpenzimit ishte pasi që disa kontrata për furnizime dhe shërbime kanë qenë me vlerë më të ultë krahasuar me atë të planifikuar për shkak të kërkesave të ulëta dhe anulimit të disa trajnimeve të planifikuara; si dhe
- Buxheti final për shpenzimet komunale krahasuar me buxhetin fillestar ishte i njëjtë. Realizimi i shpenzimeve ishte në vlerë 591€ apo 16%. Pothuaj, vlera e njëjtë e shpenzimeve ishte edhe vitin paraprak.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga AAC në vitin 2023 ishin në vlerë 3,344,034€. Ato kanë të bëjnë me taksën e sigurisë së udhëtarëve dhe taksa/tarifa tjera të vendosura nga AAC-ja.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	3,651,842	3,651,842	3,344,034	2,899,912	2,054,903
Të hyrat jo tatimore	3,651,842	3,651,842	3,344,034	2,899,912	2,054,903

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2022 të AAC ka rezultuar në dy rekomandime kryesore. AAC kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, një (1) rekomandim është zbatuar si dhe një (1) nuk është adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pagat dhe mëditjet	Drejtori i Përgjithshëm të sigurojë, që të gjitha pozitat kanë marrë miratimin sipas legjislacionit në fuqi si dhe të ndërmarrë masa që të gjithë punonjësit të marrin pagën në bazë të nivelit të miratuar të pagave.	Sistemimi i stafit dhe pagat janë bërë sipas ligjit të ri.	I zbatuar
2.	Pasuritë	Drejtori i përgjithshëm duhet të sigurojë, që zyrtarët përgjegjës të bëjnë regjistrimin e pasurive jo kapitale dhe stoqeve në sistemin e-pasuria.	Edhe këtë vit përsëritet i njëjti rekomandim sikurse vitin paraprak. Referencë e çështjes B1.	Nuk është adresuar


Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm




Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Vlora Duraku, Udhëheqëse e ekipit



Mirlinda Beqiri, Anëtare e ekipit



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionit i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

IZVEŠTAJA REVIZIJE ZA GODIŠNJE FINANSIJSKE IZVEŠTAJE
AUTORITETA CIVILNOG VAZDUHOPLOVSTVA KOSOVA ZA
2023. GODINU

Priština, juni 2024.godine.

SADRŽAJ IZVEŠTAJA

- 1 Mišljenje revizije
- 2 Nalazi i preporuke
- 3 Rezime informacija za planiranje i sprovođenje budžeta
- 4 Napredak u sprovođenju preporuka

Aneks I: Pismo potvrde

Aneks II: Objašnjenje u vezi sa različitim vrstama mišljenja koje primenjuje NKR i drugim delovima Izveštaja revizije

*Ovaj Izveštaj je prevod sa originalne verzije na albanskom jeziku. U slučaju nedoslednosti provladava verzija na albanskom jeziku.

1 Mišljenje revizije

Završili smo reviziju finansijskih izveštaja Autoriteta Civilnog Vazduhoplovstva Kosova za godinu koja se završava 31. decembra 2023. godine, u skladu sa Zakonom o Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova i Međunarodnim Standardima Vrhovnih Institucija Revizije (MSVIR). Revizija je izvršena prvenstveno kako bi nam omogućila da izrazimo mišljenje o finansijskim izveštajima i zaključak o usaglašenosti sa nadležnim organima.¹

Ne-modifikovano mišljenje o godišnjim finansijskim izveštajima

Završili smo godišnje finansijske izveštaje Autoriteta Civilnog Vazduhoplovstva Kosova (ACVK) koji sadrže izveštaj o primanjima i uplatama u gotovini, izveštaj o izvršenju budžeta i beleške objašnjenja o finansijskim izveštajima, uključujući rezime značajnih računovodstvenih politika i drugih izveštaja², za godinu koja se završila 31. decembra 2023.

Prema našem mišljenju, Godišnji Finansijski Izveštaji Autoriteta Civilnog Vazduhoplovstva Kosova, predstavljaju istinitu i realnu sliku u svim materijalnim aspektima, u skladu sa Međunarodnim Standardima Računovodstva za Javni Sektor, prema računovodstvu zasnovanom na gotovini.

Osnova za mišljenje

Revizija je izvršena u skladu sa Međunarodnim Standardima Revizije Vrhovnih Institucija Revizije (MSVIR). Prema ovim standardima naše odgovornosti su opisane ispod kod dela 'Odgovornosti Revizora za Reviziju Finansijskih Izveštaja'. U skladu sa INTOSAI-P-10, MSVIR 130, Etički kodeks NKR-a kao i drugim relevantnim zahtevima za reviziju GFI budžetskih organizacija, NKR je nezavisna od subjekta revizije. Smatramo da su revizorski dokazi koje smo prikupili dovoljni i prikladni za osiguranje osnovu za mišljenje.

Zaključak o usklađenosti

Izvršili smo reviziju da li su prateći procesi i transakcije u skladu sa utvrđenim kriterijumima revizije koji proizilaze iz zakona koji se primenjuje na subjekt revizije u kontekstu korišćenja finansijskih sredstava.

Po našem mišljenju, transakcije izvršene u procesu izvršenja budžeta ACVK bile su, u svim materijalnim aspektima, u skladu sa utvrđenim kriterijumima revizije koji proizilaze iz primenljivog zakonodavstva za subjekat revizije u kontekstu upotrebe finansijskih izvora.

Osnova za zaključak

Revizija je izvršena u skladu sa Međunarodnim Standardima Revizije Vrhovnih Institucija Revizije (MSVIR). Prema ovim standardima naše odgovornosti su opisane ispod kod dela 'Odgovornosti Revizora za Reviziju Finansijskih Izveštaja'. U skladu sa INTOSAI-P-10, MSVIR 130, Etički kodeks NKRa kao i drugim relevantnim zahtevima za reviziju GFI budžetskih organizacija, NKR je nezavisna od subjekta revizije. Smatramo da su revizorski dokazi koje smo prikupili dovoljni i prikladni za osiguranje osnovu za zaključak.

Odgovornosti Menadžmenta i upravnih organa/upravljačkih za godišnje finansijske izveštaje

Generalni Direktor odgovoran je za pripremu i realnu prezentaciju finansijskih izveštaja u skladu sa Međunarodnim Standardima Računovodstva u Javnom Sektoru - Finansijsko Izveštavanje zasnovano na Računovodstvu Gotovine. Takođe, Generalni Direktor odgovoran je za uspostavljanje unutrašnjih kontrola, za koje utvrdi da su neophodne kako bi se omogućilo sastavljanje finansijskih izveštaja, bez pogrešnog prikazivanja materijalnih izveštaja izazvanih bilo prevarom ili greškom. To uključuje ispunjavanje zahteva koji proizilaze iz Zakona br. 03/L-048 o Upravljanju Javnim Finansijama i Odgovornosti (sa dopunama i izmenama) i Uredba br. 01/2017 o Godišnjem Finansijskom Izveštavanju Budžetskih Organizacija.

Generalni Direktor je odgovoran za obezbeđivanje nadzora nad postupkom finansijskog izveštavanja Autoriteta Civilnog Vazduhoplovstva Kosova.

Odgovornost Menadžmenta o Usaglašenosti

Menadžment Autoriteta Civilnog Vazduhoplovstva Kosova je takođe odgovoran za korišćenje finansijskih resursa Autoriteta Civilnog Vazduhoplovstva Kosova u skladu sa Zakonom o Upravljanju Javnim Finansijama i Odgovornosti i svim ostalim važećim pravilima i propisima³.

Odgovornost Generalnog Revizora za reviziju GFI-a

Naši ciljevi su da pružimo razumno uverenje da finansijski izveštaji u celini ne sadrže materijalno značajne pogreške, bilo zbog prevare ili greške, i da izdajemo/izradimo revizorski izveštaj koji uključuje naše mišljenje. Razumna sigurnost je visoki stepen sigurnosti međutim ne garantuje da će revizija koja se vrši u skladu sa MSVIR uvek identifikovati materijalno pogrešno prikazivanje kada ono postoji. Pogrešna prikazivanja se mogu pojaviti usled prevare ili greške a smatraju se materijalnim ukoliko, pojedinačno ili u grupi, razumno očekuje da utiču u ekonomskim odlukama korisnika koje se donose na osnovu ovih finansijskih izveštaja.

Naš cilj je takođe da izrazimo revizorsko zaključak o usklađenosti relevantnih vlasti Autoriteta Civilnog Vazduhoplovstva Kosova sa kriterijumima revizije utvrđenim važećim zakonodavstvom u kontekstu korišćenja finansijskih sredstava, u vezi sa revidiranog subjekta.

Kao deo revizije u skladu sa Zakonom o NKR i ISSAI, vršimo profesionalnu presudu i održavamo profesionalni skepticizam tokom cele revizije. Mi takođe:

- Identifikujemo i procenimo rizike od materijalno značajnih pogrešnih prikazivanja finansijskih izveštaja, bilo zbog prevare ili greške, izradimo i izvršimo revizorske postupke koji odgovaraju na te rizike, i pribavimo revizijske dokaze koji su dovoljni i prikladni da obezbedimo osnovu za naše mišljenje. Rizik od ne otkrivanja materijalno značajnih pogrešnih navoda koji nastaju kao rezultat prevare veći je od onog koji je rezultat greške, jer prevara može uključivati manipulaciju, falsifikovanje, namerne propuste, lažno predstavljanje ili zaobilaženje unutrašnjih kontrola.

- Identifikujemo i procenimo rizike neusklađenosti sa vlastima, bilo zbog prevare ili greške, izradimo i izvršimo revizorske postupke koji su odgovorni za te rizike, i pribavimo revizijske dokaze koji su dovoljni i prikladni da pruže osnovu za naš zaključak o usklađenosti sa vlastima. Rizik od ne otkrivanja materijalno značajnih pogrešnih navoda koji nastaju kao rezultat prevare veći je od onog koji je rezultat greške, jer prevara može uključivati manipulaciju, falsifikovanje, namerne propuste, lažno predstavljanje ili zaobilaženje unutrašnjih kontrola.
- Obezbeđujemo da razumemo unutrašnju kontrolu relevantnu za reviziju, radi izrade revizorskih postupaka koji su prikladni, ali ne u svrhu izražavanja mišljenja o efektivnosti interne kontrole Autoriteta Civilnog Vazduhoplovstva Kosova.
- Procenimo prikladnost korištenih računovodstvenih politika i razumnost računovodstvenih procena i povezanih otkrivanja izvršene od strane menadžmenta.
- Procenimo ukupnu prezentaciju, strukturu i sadržaj finansijskih izveštaja, uključujući obelodanjivanja, da bi se osigurali da finansijski izveštaji prikazuju transakcije i osnovne događaje realno i tačno.

Između ostalog, komuniciramo sa menadžmentom i odgovornima za upravljanje, i u vezi sa obimom i vremenom revizije i važnim nalazima revizije, uključujući sve značajne nedostatke interne kontrole koje identifikujemo tokom revizije.

Od pitanja koja su preneti menadžmentu, identifikujemo ona pitanja koja su bila najrelevantnija u reviziji finansijskih izveštaja tekućeg perioda i koja se smatraju ključnim revizorskim pitanjima. Izveštaj revizije objavljuje se na veb stranici NKR-a, sa izuzetkom informacija koje su klasifikovane kao osetljive ili zbog drugih zakonskih i administrativnih zabrana, u skladu sa važećim zakonodavstvom

2 Nalazi i preporuke⁴

Tokom revizije, uočili smo oblasti za potencijalno poboljšanje, uključujući unutrašnju kontrolu, koje su predstavljene u nastavku za vaše razmatranje u obliku nalaza i preporuke. Ovaj nalaz i preporuka imaju za cilj da izvrše neophodnu korekciju finansijskih informacija predstavljenih u finansijskim izveštajima, uključujući obelodanjivanja u obliku napomena sa objašnjenjima i da poboljšaju unutrašnje kontrole u vezi sa finansijskim izveštavanjem i usaglašenošću sa ovlašćenjima u vezi sa upravljanjem sredstvima u javnom sektoru.

Ovaj izveštaj je rezultirao jednom (1) ponovljenom preporukom iz prethodne godine. Mi ćemo pratiti (razmatrati) ovu preporuku tokom revizije sledeće godine

Što se tiče statusa preporuka iz prethodne godine i stepena njihove implementacije, vidi poglavlje 4.

2.1 Ostala pitanja finansijskog upravljanja i usklađenosti

2.1.1 Kapitalna i nekapitalna imovina

Neto vrednost prikazana u GFI kapitalne imovine je 8,765€, ne kapitalne imovine je 16,930€, a vrednost akcija je 3,499€.

Pitanje B1 - Neregistracija ne kapitalne imovine u sistemu e-imovine

Nalaz član 6.3 Uredbe MF br. 02/2013 o upravljanju nefinansijskom imovinom u budžetskim organizacijama, precizira da kapitalna imovina mora biti registrovana u ISUFK, dok nekapitalna imovina i zalihe moraju biti registrovani u sistemu "e-imovina".

Ne-kapitalna imovina (ispod 1,000€) nije registrovana u sistemu e-imovine, uprkos tome, ACVK ima unutrašnji registar u Ekcel-u iz kojeg su otkrili ove informacije u finansijskim izveštajima.

Ovo se desilo zbog nedovoljne posvećenosti službenika odgovornih za registraciju imovine u sistemu.

Utica Neregistrovanje imovine u sistemu e-imovine utiče na neispunjavanje zakonskih uslova za upravljanje imovinom. Takođe, registracija ne kapitalne imovine u Ekcel-u, gde postoji mogućnost promene u bilo kom trenutku bez ostavljanja traga, povećava rizik da informacije objavljene u GFI mogu biti netačne i nepotpune.

Preporuka B1 Generalni direktor mora da obezbedi da odgovorni službenici registruju ne kapitalnu imovinu u sistemu e-imovine.

Odgovor rukovodstva entiteta (slaže se)

3 Rezime informacija za planiranje i sprovođenje budžeta

U ovom poglavlju dali smo sažetak informacija o izvorima budžetskih sredstava, utrošku sredstava i prikupljenim prihodima, po ekonomskim kategorijama. Ovo je ilustrovano kroz sledeće tabele i grafikone:

Tabela 1. Rashodi prema izvorima budžetskih sredstava (u €)

Opis	Početni budžet	Konačni budžet ⁵	2023 Troškovi	2022 Troškovi	2021 Troškovi
Izvori sredstava	922,281	810,061	739,945	750,068	876,303
Vladini grantovi – Budžet	922,281	804,133	739,945	750,068	876,303
Spoljne donacije	0	5,928	0	0	0

Završni budžet je manji od početnog budžeta za 112,220€. Ovo smanjenje je rezultat Odluke Vlade br. 69/2023 od 27.12.2023.godine.

U 2023. godini ACVK je utrošilo oko 91% završnog budžeta ili 739,945€, sa povećanjem od 7% u odnosu na 2022. godini. Objašnjenja za trenutnu poziciju su detaljno navedena u nastavku.

Tabela 2. Rashodi sredstava po ekonomskim kategorijama (u €)


Opis	Početni budžet	Konačni budžet	2023 Troškovi	2022 Troškovi	2021 Troškovi
Rashodi sredstava po ekonomskim kategorijama	922,281	810,061	739,945	750,068	876,303
Plate i dnevnice	768,543	650,395	650,395	693,109	768,117
Robe i usluge	150,000	155,928	88,958	56,377	106,378
Komunalije	3,738	3,738	591	582	1,808

Objašnjenja za promene u budžetskim kategorijama su sledeće:

- Konačni budžet za plate i dnevnice u poređenju sa početnim budžetom smanjen je za 118,148€, kao rezultat odluke Vlade 69/2023 od 27.12.2023. godine. Ova sredstva su povučena kao budžetske uštede. Završni budžet je realizovan 100%;

- Konačni budžet za robe i usluge u poređenju sa početnim budžetom povećan je za 5,928€. Konačni budžet je realizovan oko 57%, ova niska vrednost rashoda je zbog toga što su neki ugovori za nabavku i usluge bili manje vrednosti u odnosu na planirani zbog niskih zahteva i otkazivanja nekih planiranih obuka; i

- Konačni budžet za opštinske troškove u poređenju sa početnim budžetom bio je isti. Realizacija rashoda iznosila je 591€ ili 16%. Skoro isti iznos rashoda bio je i prethodne godine.



Prihodi koje je ACVK ostvarilo u 2023. godini iznosili su 3,344,034€. Oni se odnose na porez na bezbednost putnika i druge poreze/takse koje nameće ACVK.

Tabela 3. Prihodi (u €)

Opis	Početni budžet	Konačni budžet	2023 Prijemi	2022 Prijemi	2021 Prijemi
Ukupno prihodi	3,651,842	3,651,842	3,344,034	2,899,912	2,054,903
Neporeski prihodi	3,651,842	3,651,842	3,344,034	2,899,912	2,054,903

4 Napredak u sprovođenju preporuka

Izveštaj revizije o GFI-a ACVK-a za 2022. je rezultirao sa dve glavne preporuke. ACVK je pripremio Akcioni plan koji predstavlja način na koji ću ja sprovoditi date preporuke. Do kraja naše revizije za 2023. godinu, jedna (1) preporuka je implementirana, a jedna (1) tek treba da se adresira. Za potpuniji opis preporuka i načina na koji su one adresirane, pogledajte Tabelu 3 (ili Tabelu preporuka).

Tabela 4 Rezime preporuka iz prethodne godine

Br	Oblast revizije	Preporuke u 2022 .godini.	Preduzeti postupci	Status
1.	Plate i dnevnice	Generalni direktor mora da obezbedi da su sve pozicije odobrene u skladu sa zakonima na snazi i da preduzme mere da svi zaposleni primaju platu na osnovu odobrenog nivoa plata.	Kadrovski sistem i plate napravljeni su po novom zakonu.	Sprovedena
2.	Imovine	Generalni direktor mora da obezbedi da odgovorni službenici registruju ne-kapitalnu imovinu i zalihe u sistemu e-imovine.	I ove godine se ponavlja ista preporuka kao i prethodne godine. Referenca pitanja B1.	Nije adresirano

Vlora Spanca, Generalna Revizorka

Emine Fazliu, Pomoćnica Generalne Revizorke

Jusuf Kryeziu, Direktor Revizije

Vlora Duraku, Vođa tima

Mirlinda Beqiri, Član tima

Dodatak I: Pismo potvrde

				REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
KATEGORIA E DOKUMENTIT DATUM PRILIDHJE / DATE RECEIVED: 27-05-2024				Nr. i prot. 2024/20P/171 Br. prot. / Prot. Nr.			
Klasifikimi / Classification: 05		Shifri i klasifikimit / Classification Code: 47		Nr. i Prot. / Prot. No.: 659		Nr. i Faqeve / Br. Stranica: 1	
Hyrja / Vazhdon / Daku / Slazhdon / Brëndshëm / Interna / Interna				Kopje / Copy: 1 Data / Datum: 24/05/2024			

Republika e Kosovës
 Republika Kosovo - Republic of Kosovo

CAA
 Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
 Autoritet Civilian Vazhdplovstva Kosova
 Civil Aviation Authority of Kosovo

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjen dhe rekomandimin dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Burim Dinarama, U.D. Drejtor i Përgjithshëm

Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës

Data: 24 Maj 2024

Dodatak II: Objašnjenja različitih vrsta mišljenja revizije primenjenih od strane NKR i drugih delova Izveštaja Revizije

Izveštaj revizora o finansijskim izveštajima⁸ treba da sadrži mišljenje o finansijskim izveštajima, na osnovu zaključaka izvedenih iz dokaza dobijenih tokom revizije. Kada se revizija vrši radi procene usklađenosti sa drugim zakonima i propisima, revizori imaju dodatnu odgovornost da izveštavaju o usklađenosti sa nadležnim organima⁹, što rezultira zaključkom o usklađenosti.

U cilju utvrđenja da li je mišljenje o finansijskim izveštajima modifikovano ili nije modifikovano, revizor treba da obezbedi da rezultati revizije uključuju otkriveni ne materijalni ili otvorene druge nepravilne izjave proširene ili jedan (ili više) moguće pretpostavljenom u slučaju ograničenja delokruga.

Pogrešno prikazivanje je razlika između prijavljenog iznosa, klasifikacije, prezentacije ili obelodanjivanja artikla finansijskog izveštaja i količine, klasifikacije, prezentacije ili obelodanjivanja koja zahteva da artikal bude u skladu sa primenljivim okvirom finansijskog izveštavanja. Pogrešna prikazivanja mogu nastati iz greške ili prevare.

(odlomak od MSVIR 200)

Forma mišljenja

Ne-modifikovano mišljenje

Formuliše se kada nisu pronađene pogrešne izjave ili neusklađenosti ili su pronađene pogrešne izjave ili neusklađenosti, jedna ili objedinjena, što nije jednaka sa ili ne premašuje nivo materijalnosti finansijskih izveštaja u celini ili pogrešnih prikazivanja i/ili odstupanja otkrivena u određenoj klasi transakcija nije jednaka ili premašuje nivo najnižeg materijalnosti utvrđen za tu klasu transakcija. Takođe se formuliše ako nema ograničenja obima ili kada ograničenje obima ne može dovesti do izbegavanja značajnih pogrešnih prikazivanja i / ili ne usklađivanja.

Ograničenje obima nastaje kada revizor nije u mogućnosti da prikupi dovoljno revizijskih dokaza da bi zaključio da finansijski izveštaji u celini su slobodni od materijalnog pogrešnog prikazivanja.

Revizor treba da izrazi **jedno ne-modifikovano mišljenje revizije** ukoliko se zaključi da su finansijski izveštaji pripremljeni, sa svih materijalnih gledišta u skladu sa važećim finansijskim okvirom..

Promene mišljenja u revizorskom izveštaju

Revizor treba da modifikuje mišljenje revizije na revizorskom izveštaju ukoliko se zaključi da, na osnovu prikupljenih dokaza revizije, finansijski izveštaji kao celina nisu bez materijalnih grešaka, ili nije u mogućnosti da dobije dovoljno odgovarajućih dokaza revizije da bi zaključio da su finansijski izveštaji kao celina bez materijalno pogrešnih prikazivanja i/ili ne usklađenost, revizor treba da modifikuje mišljenje u izveštaju revizije.

Modifikovana mišljenja mogu biti.

- Kvalifikovane,
- Protivne, il
- Odbijene

Kvalifikovano mišljenje

Formuliše se kada se otkriju pogrešna prikazivanja i / ili odstupanja, pojedinačni ili agregat koji je jednak ili premašuje nivo značajnosti finansijskih izveštaja u celini ili kada su pogrešna prikazivanja i / ili neslaganja otkrivena unutar date klase transakcija jednaka ili prevaziđe nivo niže značajnosti utvrđenog za tu klasu transakcija. Takođe je formulisan ako ne postoji ograničenje obima koje ne može dovesti do izbegavanja značajnih pogrešnih prikazivanja.

Protivno mišljenje

Formuliše se kada se otkriju pogrešna prikazivanja i / ili neusklađenosti, pojedinačna ili agregat, što premašuje nivo značajnosti finansijskih izveštaja u celini ili kada se pogrešno prikazivanje i / ili neusaglašenosti otkrivena u okviru određene klase transakcija daleko premašuju nivo nižeg materijalnosti utvrđen za tu klasu transakcija.

“Rasprostranjena” je termin koji se koristi u kontekstu grešaka i / ili neusklađenosti da bi se opisali efekti grešaka i / ili neusklađenosti na finansijske izveštaje ili potencijalni efekti grešaka i / ili neusklađenosti na finansijskim izveštajima, ako postoje takvi, koji nisu otkriveni zbog nemogućnosti pribavljanja dovoljno adekvatnih revizorskih dokaza. Rasprostranjeni efekti u finansijskim izveštajima su oni koji su, po revizorovoj proceni:

- a) Ne ograniče se samo na elemente, račune ili određene stavke finansijskih izveštaja
- b) Ako se tako ograniče, predstavljati ili može predstavljati značajan deo finansijskih izveštaja; ili
- c) U vezi sa obelodanjivanjima, su od suštinskog značaja za razumevanje finansijskih izveštaja.

Odricanje od mišljenja

Formuliše se kada ograničenje obima, tj. nemogućnosti da obezbede dovoljne odgovarajuće revizorske dokaze, je materijalne ili raširene prirode.

Paragrafi Isticanja Pitanja i paragrafi Ostalih Pitanja na revizorskom izveštaju

Ukoliko revizor smatra potrebnim da skrene pažnju na pitanje prikazano ili obelodanjeno na finansijskim izveštajima koja je od velikog značaja za njihovo razumevanje finansijskih izveštaja, ali postoje dovoljno prikladnih dokaza da to pitanje nije materijalno pogrešno prikazano na finansijskim izveštajima, revizor će u revizorskom izveštaju uključiti jedan paragraf o Isticanju Pitanja. Isticanje Pitanja se treba odražavati samo na informaciju prikazanu ili obelodanjenu na finansijskim izveštajima.

Paragraf o isticanju pitanja treba:

- da se uključi odmah nakon mišljenja revizije;
- da koristi naslov "Isticanje Pitanja" ili neki drugi prikladni naslov;
- da uključi jasnu referencu na pitanje koje se ističe i da naznači gde se mogu naći relevantna obelodanjivanja na finansijskim izveštajima koja u potpunosti opisuju to pitanje; i
- ukazati da revizorsko mišljenje nije modifikovano u odnosu na istaknuto pitanje.

Ukoliko revizor smatra neophodnim da komunicira određeno pitanje, osim onih koje su predstavljene ili obelodanjene u finansijskim izveštajima, koja po prosudi revizora je važna za korisniku u cilju shvatanja revizije, odgovornosti revizora ili revizorski izveštaj, a pod uslovom da to nije zabranjeno zakonom ili pravilima, treba da se pripremi paragraf sa naslovom "Ostala Pitanja", ili nekim drugim pogodnim naslovom. Ovaj paragraf treba da se pojavi odmah iza mišljenja i nakon svakog pasusa kod Isticanja Pitanja

Poslednje beleške

- ¹ Usklađenost sa vlastima – poštovanje svih relevantnih zakona, pravila, uredba, standarda i dobre prakse u javnom sektoru
- ² Ostali izveštaji su zahtev člana 8 Uredbe 01/2017 o godišnjem finansijskom izveštavanju
- ³ Kolektivno se naziva poštovanje vlasti
- ⁴ Pitanje A i Preporuka A – znači nova pitanja i preporuke
Pitanje B i Preporuka B – znači ponovljena pitanja i preporuke
Pitanje C i Preporuka C- označavaju delimično ponovljena pitanja i preporuke.
- ⁵ Konačni budžet – budžet odobren od strane Skupštine, a zatim usklađen od strane Ministarstva finansija
- ⁶ Finansijski izveštaji u javnom sektoru takođe uključuju izveštaj(e) o izvršenju budžeta
- ⁷ Usklađenost sa vlastima: usklađenost sa zakonima, uredbama, standardima ili dobrim praksama.

